



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 1 SHTATOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 01. SEPTEMBRA 2016. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa sipas kërkesës së deputetit VisarYmeri, i mbështetur edhe nga 7 deputetë nënshkrues, në lidhje me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës,
5. Interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 10 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi,
7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015,
8. Propozimi i GP të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Interpelacija Premijera Isa Mustafa, na zahtev poslanika VisarYmeri, uz podršku 7 poslanika potpisnika, u vezidržavnog telefonskog koda Republike Kosova,
5. Interpelacija Premijera Isa Mustafa, na zahtev poslanika IsmajlKurteshi, uz podršku 10 poslanika potpisnika u vezi aktualne političke situacije na severnom delu Republike Kosova,
6. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji sporazuma o državnoj granici između Republike Kosova i Crne Gore,
7. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o regulativnom autoritetu za elektronske i poštanske komunikacije za2015,
8. Predlog PG - AAK o zameni članova parlamentarnih komisija.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Po e fillojmë punën e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2016.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, ju njoftoj për zëvendësimin e deputetes nga radha e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës...

Ismajl, veç ta kryejmë punën e deputetit, se e kemi një deputet që duhet ta marrë bekimin tuaj.

Me kërkesë të kryetarit të Kuvendit e me vendim të presidentit të Republikës së Kosovës është bërë zëvendësimi i deputetes në Kuvendin e Republikën së Kosovës, zonjës Kimete Bytyqi, kandidate e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, zëvendëson ish-deputeten, zonjën Alma Lama.

Betimi i deputetit është një veprim i paraparë me Kushtetutë dhe me Rregulloren e Kuvendit. Tekstin e Deklaratës së betimit e ka deputetja para vete dhe e njëjta duhet ta nënshkruajë personalisht. Për të përmbushur këtë detyrim, lus deputeten që të ngrihet në këmbë, ta dëgjojë tekstin që do ta lexoj unë dhe vetëm në fund të shqiptojë fjalën “Betohem”.

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”. Betohem!

KIMETE BYTYQI: Betohem!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Urime, zonja deputete! Të dëshirojmë mirëseardhje dhe ftoj ta nënshkruani tekstin e Deklaratës së betimit.

Ismajl Kurteshi, deputet i Lëvizjes “Vetëvendosje, e ka kërkuar fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Zoti kryetar,

Edhe ju, zoti sekretar i Kuvendit të Kosovës,

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kreu XI, pika 37, në pikën 2, thuhet: “Sesioni vjeshtor i punimeve të Kuvendit të Kosovës fillon të hënën e dytë të shtatorit. Sot nuk jemi as në të hënën e parë. Pra, do të duhej seanca e parë të thirrej vetëm pas 12 shtatorit. Çdo seancë e thirrur para 12 shtatorit është në kundërshtim me këtë rregullore që ne e kemi aprovuar që e ka fuqinë e ligjit dhe ju po veproni në kundërshtim me ligjin. Kështu që Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” kërkon që kjo seancë të ndërpritet menjëherë dhe seancën ta thirrni pas të hënës së dytë të shtatorit! Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar deputet, faleminderit! Ende s'e kemi përfunduar seancën pranverore, kështu që jemi duke hyrë në dimëroren drejtpërdrejt. Prandaj jemi brenda rregullores, po punojmë në mënyrë dinjitoze.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri 30 minuta, diskutimi në emër të Grupit Parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta.

Diskusimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, do të thotë edhe i deputetit tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Këtu para meje i kam tre deputetë, të cilët e kanë kërkuar fjalën. Do të shkojmë në bazë të radhës, për hir të korrektësisë, se po thonë po i jap fjalën më herët a më vonë! Margarita Kadriu është e para, kjo flet në emrin personal, Kujtim Paqaku, a flet në emër të grupit e tregon, edhe Besa Gaxheri, vetë.

MARGARITA KADRIU: Faleminderit,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Përderisa klasa politike kosovare është duke u marrë me njëri-tjetrin dhe veten, shteti i Kosovës po përballet në Gjykatën e Arbitrazhit edhe me padinë e radhës.

Para më shumë se një muaji morëm lajmin për vendimin e Gjykatës së Odës Ndërkombëtare Ekonomike në Paris kundër Republikës së Kosovës, pasi shtypshkronja shtetërore e Austrisë kishte ngritur padi për skandalin e pasaportave dhe shteti i Kosovës detyrohet të paguajë rreth 5 milionë euro në xhirollogarinë e shtypshkronjës austriake.

Por, lajmet e këqija për qytetarët dhe shtetin e Kosovës nuk përfundojnë me kaq! Mediat kanë raportuar se shoqëria e shumëpërfolur “Devolli”, përmes arbitrazhit po kërkon që t'ia marrë shtetit të Kosovës hiç më pak se edhe 50 milionë euro të tjera shtesë, për gjoja në emër të 100 mijë numrave shtesë që nuk ia paska dhënë Telekomit i Kosovës.

Mirëpo, “qershia mbi tortë” vjen sërish me skandalet në Postë-Telekomin e Kosovës.

Në një artikull para disa ditësh kemi pasur rastin të lexojmë në një gazetë gjermane, “Frankfurter Allgemeine Zeitung”, se “AxosCapital” ka paditur shtetin e Kosovës para gjyqtarëve të Arbitrazhit në Uashington.

“AxosCapital”, të nderuar, kërkon nga Kosova hiç më pak se 390 milionë euro, po e përsëris, 390 milionë euro.

Pra, po rrezikojmë të humbim edhe 400 milionë euro për një proces të përcjellë me dyshime, akuza, e plot prapaskena.

Çka tash, nëse Kosova e humb kontestin si në rastin e tenderit të pasaportave dhe detyrohet të paguajë edhe 390 milionë euro të tjera, një shumë sa një e katërta e buxhetit?

Një gjë e tillë për Republikën tonë të brishtë do të ishte një goditje dhe tronditje e tmerrshme financiare. Dikush duhet të japë përgjegjësi dhe jo vetëm thjesht përgjegjësi politike, por juridike dhe penale, qoftë ata të nivelit më të lartë, e deri te zyrtari më i thjeshtë i fajshëm.

Si gjithnjë, është taksapaguesi i varfër ai që e paguan faturën e çdo dështimi, ndonëse do të duhej të kishim një llogaridhënie të zyrtarëve përgjegjës pas një hetimi serioz të Prokurorisë së Shtetit.

Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj janë lodhur nga dëmet që po ua sjellin zyrtarët e shtetit dhe populli nuk mund t'i paguajë deri në pakufi nga paratë e veta hiç më pak se tash edhe 450 milionë euro në arbitrazhe gjyqësore ndërkombëtare, edhe atë për shkak të korrupsionit të zyrtarëve të lartë të shtetit dhe krimit të organizuar të instaluar në institucione.

Pyetja që vazhdon të mbetet pa përgjigje është se deri kur Qeveria e Kosovës do të heshtë për të gjitha këto e shumë të tjera goditje dhe dëme të kundërligjshme, që i janë shkaktuar shtetit dhe qytetarëve, duke mos marrë as edhe të vetmen masë si një veprim të parë të llogaridhënies së zyrtarëve të lartë të shtetit.

Njëkohësisht, pyetja tjetër i takon Prokurorisë.

KRYETARI: Regjia, mos ia u ndal fjalën, por, kolegë deputetë, mos e zgjatni shumë. Kërkoj falje!

MARGARITA KADRIU: Njëkohësisht, po e përfundoj me një fjali, i nderuar kryetar! Shtrohet edhe pyetja, përse vazhdon të mos veprojë Prokuroria e Shtetit Ex-officio për të hetuar seriozisht të gjithë të korruptuarit lidhur me rastet që i përmenda deri më tani, dhe jo vetëm, në kërkim për të zbardhur veprat e konsumuara penale dhe të akuzuarit eventual të përballen me drejtësinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kujtim Paqaku, deputet i Grupit Parlamentar “6+”.

KUJTIM PAQAKU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
I nderuar kryetar,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuara deputete,
Të nderuar deputetë,
Të nderuara media,
Unë para jush jam me emër e mbiemër, Kujtim Paqaku, i përkas komunitetit rom.

Jam anëtar i Kryesisë së Kongresit Botëror të Romëve po ashtu shkrimtar i komunitetit rom, e jo shkrimtar i komunitetit magjup, as jo shkrimtar i komunitetit gabel.

Këto dy thënie i kemi dëgjuar këto ditë në Insajderin e famshëm ky miku im i nderuar, shumë i respektuar zoti Grabovci edhe zonja e nderuar deputete Safete Hadërgjonaj përbuzin komunitetin rom me fjalën “gabel” dhe “magjup”. Ky është diskriminim klasik që ndodh në shtëpinë numër një të shtetit të Kosovës.

I nderuar kryetar!

Unë nuk kam fuqi juridike të ngre procedura, sepse e kam vështirë sidomos deputetin Grabovci që më ka ndihmuar shumë, kam respekt për zonjën Safete Hadërgjonaj.

Unë nuk largohem nga kjo foltore tani, të shoh dikush prej shqiptarëve kolegëve të mi, së paku, kryetar, pres edhe ndihmën tuaj që së paku të kërkon një falje njerëzore, sepse keni bërë atak ndaj fëmijëve në shkollë, atak ndaj të sëmurëve në spital, atak ndaj studentëve dhe ndaj popullatës 15 milionëshe në Evropë.

Pres prej jush, dikush, një deputet shqiptar apo vetë kryetari, të kërkojë falje. Unë do të qëndroj këtu.

KRYETARI: Zoti Paqaku...

(Duartrokitje)

Zoti Paqaku, si kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës i kërkoj falje publikisht komunitetit rom për çdo lëndim të tillë, i cili ka mundur të ndodhë, një komunitet jashtëzakonisht lojal i Republikës së Kosovës dhe e ndiej veten po ashtu të fyer. Kërkoj falje!

KUJTIM PAQAKU: Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Zoti Grabovci, urdhëro, pasi ta përmendën fjalën.

ADEM GRABOVCI: Zoti Paqaku, të drejtohem ty dhe të gjithë të tjerëve, të cilët janë objekt të një bisede që, po e them me përgjegjësi të plotë, personalisht unë dhe familja ime jemi duke kaluar çaste tepër të vështira të terrorit. Vlerësoj dhe të falënderoj shumë në respektin që tregove, por po ta them ty dhe të gjithë të tjerëve se të gjitha angazhimet e mia kanë qenë shumë të sinqerta, do të vazhdoj të jem shumë i sinqertë me ju dhe me të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, t’ju jap ndihmë dhe përkrahje sa herë që kërkon nga unë si një bashkështetas juaj, një vëlla, një mik juaj, dhe po ju them sinqerisht se nuk e besoj që ju i keni përjetuar dhe po i përjetoni më rëndë se sa unë dhe familja ime dhe të gjithë miqtë dhe dashamirët e mi këto fyerje, të cilat janë duke m’u bërë gjatë këtyre ditëve.

Unë ju kërkoj edhe një herë sinqerisht falje nga zemra dhe shpirti dhe shpreh keqardhje për këtë që po ndodh. Dhe, nuk e besoj që në një shtet të Evropës mund të ndodhë që për një muaj rresht të terrorizohet një njeri, një familje dhe një popull i tërë për shkak të bisedave private. Unë e pranoj se në momente të caktuara, dhe urdhëroni e këqyrni të gjitha, kam bërë përpjekje të mos e

fyej askënd, por në momente të dobësisë, jemi njerëz të gjithë dhe mund të kemi momente të dobësisë, nuk dua të arsyetoj.

U kërkoj falje të gjithëve, sinqerisht, atyre të cilët e ndiejnë veten të fyer nga ato biseda telefonike.

Ndërsa pjesën tjetër unë ia kam lënë drejtësisë, sepse besoj në shtet, besoj në institucionet e vendit tim dhe besoj se do të marrin masat edhe ndaj meje, nëse vërtet meritoj dhe kam kërkuar në mënyrën më të sinqertë, jo vetëm nga ju, jo vetëm për ato bisedat telefonike, por tërë jetën time nëse dikush konstaton se unë kam dëmtuar interesin e vendit tim, të popullit tim, me një veprim të vetëm, urdhëroni, denonconi te organet e drejtësisë! Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Gaxherri, e ka fjalën... Çka po i jep zor, Skenderbeg, merre fjalën si burrë, mos i jep zor. Qe merre fjalën, ta jap fjalën, Skënderbeg, merre fjalën. Ani, merre fjalën Fisnik Ismajli... mos bëj me gisht. Dëgjo, mos i jep zor... kurrkush s'po të tutet. Qetësohu, "take it easy", ti anglisht merr vesh.

Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Të nderuar, kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Zoti Paqaku, unë me këtë rast solidarizohem me ju dhe në këtë rast kërkoj nga Prokuroria që vërtet të merret me këtë aferë që këto ditë të gjithëve na ka shqetësuar dhe ne në Kuvend të merremi me punët, të cilat vërtet po na presin çdo ditë.

Unë sot natyrisht dola këtu para jush për t'i thënë disa fjalë në lidhje me situatën politike dhe sigurisë në vend. Pa mëdyshje, situata është e tensionuar, por që në fillim po dua t'i përgëzoj Policinë e Kosovës. Policia e Kosovës këto ditë dëshmoi se është profesionale dhe korrekte me përgjegjësitë e saja. Puna, përkushtimi, përgjegjësia, profesionalizmi, korrektësia e Policisë së Kosovës na jep shpresë në këto ditë shumë të vështira, na e argumenton se Kosova është shtet demokratik dhe po ecën drejt rrugës së vështirë, por të duhur.

Këto ditë kemi pasur momente, të cilat kanë qenë të paimagjinuara se mund të ndodhin nga shqiptarët. Ditë më parë në Kuvendin e Kosovës kemi aprovuar një rezolutë të gjithë së bashku dhe kemi dënuar sulmet terroriste mbi institucionet e vendit. Unë sinqerisht kam besuar se nuk ka parti politike shqiptare që qëndron pas këtyre sulmeve. Nuk dua të fus sot ose të flas në këtë pikë për arrestimin e aktivistëve të "Vetëvendosjes", le të merret drejtësia me ta. Dua të flas për rastin e vitit të kaluar, kur Policia e Kosovës bastisi selinë e "Vetëvendosjes" dhe gjeti maska, molotov, bombola gazi dhe armë të tjera të ftohta.

Kjo është e papranueshme, kjo nuk mund të quhet assesi më parti politike demokratike. Prokuroria nuk e di ku është me çështjen, por unë sot po kërkoj nga ju dhe Qeveria që urgjentisht ta shohim që Kosova ta sjellë në Kuvend Ligjin për partitë politike dhe të definohet qartë kufiri mes partive politike demokratike dhe lëvizjeve e organizatave terroriste. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca e ka kërkuar ndërkohë fjalën, s'ka më diskutues.

GLAUK KONJUFCA: Zonja dhe zotërinj,

Deputetë të këtij Kuvendi,

Unë nuk e kam pritur prej një të zgjedhure të popullit që do të më kthente në vitin 1998, kur ata që synonin ta mbronin interesin e Kosovës, e ishin në krye të një lufte çlirimtare, kërkoheshin të shpalleshin terrorist.

Kjo më kthej bash në atë moment, më krijoi një po kësi ndjenje shumë të kobshme, të cilën ju e sollët me fjalimin tuaj aspak të lavdishëm. Ajo që ka bërë Policia e Kosovës këto ditë, duke mbajtur më shumë konferenca shtypi se duke ofruar prova, ka qenë ajo që “Vetëvendosjes” është duke i ndodhur tashmë e disa vjet. Nuk është vetëm java e fundit që ka qenë kështu, ne si “Vetëvendosje” jemi mësuar me këtë frikësim terrorizues të popullit që po ia bën Qeveria përmes kësaj propagande të pashembullt, ku i prezanton dy-tri armë dhe thotë: “Këta janë njerëzit që e paskan gjuajtur Kuvendin e Republikës së Kosovës”.

Përpjekja që përmes ekspozimit të thjeshtë të dy-tri armëve të thuhet që fajtohet për të gjitha këto ngjarje që kanë ndodhur kohët e fundit është një subjekt politik, kjo e fut Kosovën në një “rrugë qorre”, kisha thënë, për të cilën përgjegjësinë duhet ta marrë Qeveria e Republikës së Kosovës, mediat policore, të cilat i kontrollojnë Qeveria e Republikës së Kosovës dhe agjentët që ndodhen, ta zëmë, në Departamentin Antiterror të Policisë së Republikës së Kosovës, të cilët ne i njohim edhe e dimë se si janë punësuar prej këtyre përgjimeve të klanit mafioz “pronto”, të zotit Grabovci me shokë, të cilët e dimë se nuk i kanë vendosur vetëm prokurorët si Bahri Hyseni, e njerëzit nëpër KOS, e nëpër agjenci të pavarura të Kosovës, por i kanë vendosur edhe aty ku duhet të hetohet krimi brenda Policisë së Republikës së Kosovës.

E ata njerëz, në vend që t’i ndjekin kriminelët e vërtetë, për të cilët ka prova me miliona, shpifin dhe dalin me dy-tri fotografi të telefonave e të motorëve, e i ekspozojnë dy-tri armë dhe a dini çka ndodh në seancën gjyqësore, zonja Gaxherri, se ti e bërë pyetjen se nuk e di në çfarë faze është prokuroria. Qe, po të kallëzoi unë në çfarë faze është.

Prokuroria në ditën e djeshme del edhe thotë për Frashër Krasniqin edhe për Petrit Ademin nuk kemi asnjë dëshmi, mirëpo edhe përkundër kësaj, është mirë që të mbahen në paraburgim. Çka mund të thoni për këtë, zonja Gaxherri? A është ky terroristi në Kosovë? A është ky ai i cili e paska sulmuar Kuvendin e Republikës së Kosovës, kurse për të tjerët thonë se “ende nuk kemi dëshmi të sigurta, por jemi duke i mbledhur ato”. Shihe! 4 ditë para mbajtjes së seancës kur do të votohet demarkacioni.

Pra, që t’ia jepni edhe një etiketë, edhe një njollosje lëvizjes “Vetëvendosje” që t’i provoni të gjitha metodat tuaja të paturpshme që vetëm ju dini t’i përdorni, që të mos dalë populli sot në demonstratë, sepse mediat tuaja policore e kanë krijuar përshtypjen sikur nëse dilni më 1 shtator në protestën e “Vetëvendosjes”, është njëjtë sikur të dilni në luftë.

Këtë ndjenjë, këtë atmosferë, po sikur mediat e Milosheviqit, e keni krijuar ju me kontrollimin e Policisë, me manipulimin e Policisë dhe me manipulimin e medieve duke thënë që qytetarëve të Kosovës të rrinë në shtëpi se po dolën ta shprehin pakënaqësinë atë ditë, është sikur të dalësh në luftë, mund të vritesh, do të ketë dhunë, këta janë terroristët, këta e kanë gjuajtur me zollë Kuvendin e Kosovës, e kështu me radhë.

Më vjen shumë keq për juve personalisht që jeni bërë pjesë e kësaj makinerie të turpshit dhe të propagandës.

KRYETARI: Ministri Skënder Hyseni e ka kërkuar fjalën. Zonja Gaxherri, kërkoj falje, por s' u lajmërova deri kur të pashë, e merr replikë menjëherë. A po e lë ministrin si deputete le të flasë, pastaj e merrni menjëherë fjalën.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar,
Të nderuar deputetë,
Kolegë ministra,
Të nderuar përfaqësues të medieeve,
Policia e Republikës së Kosovës sipas të gjitha vlerësimeve të paanshme ndërkombëtare është policia më profesionale, me integritetin më të lartë në Ballkanin Perëndimor.

Policia e Republikës së Kosovës... Unë ju dëgjova me shumë vëmendje, më dëgjoni ju lutem, dhe do t' ju dëgjoj gjithë ditën. Policia e Republikës së Kosovës është duke e zbatuar mandatin kushtetues dhe ligjor me saktësinë maksimale. Policia e Republikës së Kosovës është institucion "palcë kurrizore" e këtij shteti, nën kontroll civil dhe demokratik të këtij Kuvendi, të komisioneve përkatëse parlamentare dhe absolutisht është e papranueshme që Policia e Kosovës të quhet "polici kriminale", si Polici e Kosovës.

Policia e Kosovës asnjëherë... u tha se përfaqësues të policisë me prirje kriminale kanë bërë këtë apo atë. Policia e Kosovës e ka kryer punën e vet dhe e ka dorëzuar në Prokurori dhe në gjykata. Është absolutisht çështje e vlerësimit dhe gjykimit që do t' u bëjë një gjykatë e Kosovës, e paanshme, në të cilën duhet të kemi besim, në të cilën duhet të kemi besim që janë të paanshme, nuk do të lejojmë që për shkak të individëve të njolloset institucioni, as të nëpërkëmbet institucioni...

KRYETARI: Kërkoj falje, a ka mundësi ta leni të flasë. S' ka mundësi! Ani, bërtit!

MINISTRI SKENDER HYSENI: Problemi më i vogël janë individët dhe ne do të flasim, sepse Policia e Kosovës është institucioni që po e kryen punën e vet më së miri që është e mundur, dhe ne të gjithë bashkarish duhet ta përgëzojmë këtë Polici të Kosovës për punën e shkëlqyer që po bën në të gjitha frontet dhe natyrisht unë ju siguroj këtu që Inspektorati i Policisë së Kosovës do të merret në mënyrën më serioze me çdo shkelje që mund të bëjnë individët brenda Policisë së Kosovës, mirëpo jo mbi bazën e perceptimeve, jo mbi bazën e alegacioneve ose thashethemeve të kujtdo qoftë dhe nga kudo qoftë. Faleminderit!

KRYETARI: Rexhep Selimi e ka kërkuar fjalën, s' ka replikë, zonja Gaxherri, është precedent që veç unë mund ta bëj në këtë Kuvend. Edhe Glauk, as ti dy herë pasi është ... jo, s' shkon. Replikë nuk ka... hera e parë nuk mund të krijoj unë precedent.

Rexhep Selimi e ka fjalën, keni kohë kushdo ta kërkojë fjalën. Jo, jo, prit pak, ende jemi brenda 30-minutëshit. Shikoni, ku i kemi edhe mediat atje, le ta gjykojnë.

REXHEP SELIMI: Më ngadalë, keni kohë edhe ju.

Ministër, mua nuk do të më pengonte sikur të dilnit sërish pas meje këtu edhe të na përgjigjesh në nja 2-3 çështje.

Unë dua të them edhe një herë që Policia e Kosovës nuk është ajo polici çfarë po mundohet ta bëjë pushteti në Kosovë. Ka gjetur disa individë, disa eksponentë që në mënyrat dhe format se si janë graduar po tregon edhe afera “pronto” dhe i kanë nxjerrë para mediave për të kryer detyrën e “shefave të shefave”. Dhe ata nuk janë policë të Kosovës, policët e Kosovës janë ata, të cilët sot i keni lënë gjithë ditën me nga një copë bukë duke ngrënë qosheve të Parlamentit dhe i keni lënë gjithë ditën me helmata në kokë duke u munduar t’i ktheni kundër popullit. Por, ajo çfarë pretendon ...

KRYETARI: Deputetë, ju lutem, mos ndërhyini, lëreni të flasin, kërkojeni fjalën kush do.

REXHEP SELIMI: Ajo çfarë pretendon që policia paska gjetur, ngrihu ministër, e thuaj këtu: Sa armë Policia e Kosovës i ka konfiskuar deri më tani, janë qindra- mijëra. A janë qindra-mijëra terroristë në Kosovë? Sa helmata i keni gjetur nëpër shtëpitë e shqiptarëve? A janë të gjithë ata terroristë në Kosovë?

Prandaj, dua të them edhe një herë keni kujdes se jeni futur në një lojë nga e cila nuk mund të dilni. Jeni futur në një lojë, e cila është shumë e rrezikshme. Mos përdorni Policinë e Kosovës për ato agjenda, të cilët ndoshta as vetë nuk e dini se cili është përfundimi i tyre. Prandaj, dua të them edhe një herë, ministër, e keni shumë gabim. Policia e Kosovës po bën punë të mirë, por jo ato punë që ju po ia ngarkoni që ata t’i bëjnë me njësitë e tyre parapolitike në Policinë e Kosovës.

Kjo që ju doni ta bëni nuk është Policia e Kosovës, Policia e Kosovës do të jetë nesër shumë më e mirë, shumë më profesionale. Prandaj, po them edhe një herë, mos e keqpërdorni Policinë e Kosovës kundër interesave të qytetarëve të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Besa edhe Glauk nuk ka mundësi për të dytën herë, është e paprecedent të dilet në 30-minutëshin jashtë rendit të ditës.

Zonja Gaxherri, unë me forcë nuk mund të të ndal, por nuk është mirë të dalësh. Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së duhet t’i tregojë, përndryshe unë askujt deri sot nuk ia kam ndalur fjalën. Lirisht regjia ia lëshon fjalën, por mirë nuk është të dalësh, edhe nuk jam duke e parë se s’kam fuqi...

BESA GAXHERRI: Sinqerisht, s’jam duke të kuptuar hiç ty, zoti kryetar. Unë jam deputete që e di Rregulloren, unë e ngrita një çështje, dikush doli iu përgjigj çështjes sime dhe më apostrofoi. Unë kam të drejtë automatikisht në kundërshtim dhe nuk e di pse po e bëni “histori” këtë punë.

Zoti Konjufca, ju thatë që ata që e çliruan Kosovën “ju po doni t’i shndërroni në terroristë” nuk është e vërtetë, Por është mjerim, qoftë subjekti juaj politik, qoftë imi, qoftë ky tjetri tenton dhe pretendon se “ne e kemi çliruar Kosovën”, kjo pastaj na sjell...

Mbylle ti! Mbylle, mbylle, mos ulërit! Boll, boll!

Unë u ngrita sot këtu për të diskutuar jo për individë, sepse pa marrë parasysh që drejtësia në Kosovë lë për të dëshiruar shumë, ne po ndërtojmë institucione, të cilave duhet t'u besojmë. Për çdo individ, për çdo armë, le të merret drejtësia. Unë po flas për subjekt politik, ju jeni subjekt politik dhe në selinë e subjektit politik gjenden maska, molotov, bombola të gazit e armë të ftohta, kjo, zotëri, nuk do koment. Ju duhet të distancoheni vetë. Ose duhet të jeni subjekt politik, ose diçka tjetër. Dhe, këtë s'mund ta mohojë askush. Kësaj i ka ardhur fundi. Mos na shitni më patriotizëm.

Për çka kanë dalë sot protestuesit? Këtu është vendi! Ulu! Ulu, mos ulëro atje, ulu, ulu, se po na turpëron, ulu se po më turpëron edhe mua si femër. Për çka është ky Kuvend...

KRYETARI: A ka mundësi për qetësi, se jeni duke e keqpërdorur Kuvendin.

BESA GAXHERRI: Kuvendi është për të marrë vendime për këtë shtet. Ne na keni mohuar, deputetëve të mazhorancës, më shumë se një vit që të marrim vendimin, i cili është i drejtë, të cilin e kërkojnë qytetarët e këtij vendi edhe për kufirin. Ju bëni lojëra dhe bashkëpunoni me kënd t'ju sugjerojë juve, dilni në rrugë. Nuk ka nevojë në rrugë, ne jemi këtu që marrim përgjegjësinë. Secili prej nesh ka përgjegjësi politike, patriotike, tradhtare, siç e quani ju e qysh të doni, nuk keni nevojë ju të na shitni mend, as patriotizëm. Ne e kemi përgjegjësinë, secili prej nesh këtu. Dhe mjaft, ju duhet t'i merrni përgjegjësitë e partisë politike. Mjaft më!

KRYETARI: Faleminderit! Kërkoj falje, një minutë, Glauk, shko ulu në vend!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

Në fakt, kam të drejtë edhe unë të flas një minutë, fjalën do të ta jap, mos u mërzit, por vetëm një element dua ta sqaroj publikisht.

Të gjitha këto të cilat jam duke i bërë, jam duke i bërë për hir të interesave qytetare, që të mos krijohet konfliktualitet. Po të mos mendojë dikush se mund të flasë në atë foltore kur nuk dua unë. Edhe detyrimisht nuk do të flasë. Vetëm keqpërdorimi tepër i madh është abuzim me Kuvendin dhe po frikësohem se vetëm kjo, kërkoj falje publikisht, prej paraardhësve kryetarë të Kuvendit e pasardhësve që do të vijnë, që po e bëj këtë precedent, se derisa fliste zonja Gaxherri, profesori Sabri qeshej, se nuk ka replikë kur i kemi 30 minuta jashtë rendit të ditës me Rregullore. Të paktën thoni: "Po dua të flas", se e kemi gjetur një kryetar ku po dëshironi të flisni, ajo është çështje tjetër, po rregulloren edhe ligjin mos i shkelni para syve të mi. Glauk, urdhëro, vetëm e përfundojmë. Më nuk ka pika të rendit të ditës. Të lutem, mos fyeni në baza individuale, flisni politikisht!

GLAUK KONJUFCA: Shikoni, unë mund t'ju ofroj fakte të qarta përse mendoj që në Polici të Kosovës ka më shumë parapolitikë dhe ndërhyrje për ta persekutuar Lëvizjen "Vetëvendosje" se sa në vetë drejtësinë si të tillë, se sa në vetë gjyqësinë.

Qe dy fakte, të cilat mund t'ua ofroj dhe të cilat janë shumë të qarta:

E para, Trim Gashi, aktivisti i Lëvizjes "Vetëvendosje". Policia i ka montuar provat për të dhe aktivistin e kanë çuar e kanë mbajtur pesë muaj në burg me prova të montuara të këtyre strukturave, që i emëron "parapolitika" brenda policisë. Drejtësia është munduar t'i lidhë kryet

kësaj farë pune dhe nuk ka mundur. Aq keq të montuara, keq kanë qenë provat për Trimin, sa që drejtësia nuk ka mundur të vendosë ta dënojë atë, e ka lëshuar të lirë. Trimi është akuzuar për tentim atentat ndaj kryeministrit, mos harroni!

Domethënë, Lëvizjes “Vetëvendosje” ia keni veshur edhe etiketën “atentator”, tash edhe “terroriste”, tash edhe një hap më tutje me kërkesën e zonjës Gaxherri për të na shpallur të paligjshëm, jashtë politikës dhe të gjithëve të na fusni në burg. Kjo është faza e ardhshme. Në rregull, po e kuptoj.

Argumenti i dytë, Kushtrim Avdimetaj është mbajtur disa muaj në burg, s’e di a e dini. A e dini me çfarë është çuar në burg prej Policisë Kushtrim Avdimetaj? Për ty e kam, ministër, më shumë. A e dini me çfarë argumenti është çuar Kushtrim Avdimetaj në burg? Një fotografi kështu, e një njeriu me maskë, për të cilin kanë pretenduar që prapa maskës është Kushtrim Avdimetaj. A mund ta merrni me mend? A mund ta merrni me mend, që njeriu shkon në burg në Kosovë...

(Ndërprerje nga regjia)

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 6 pyetje parlamentare. Ftoj deputeten Ganimete Musliu që t’i bëjë pyetje për ministrin Skënder Hyseni. Urdhëroni, zonja deputete!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër!

Kabinet qeveritar!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë!

Unë kam bërë pyetjet parlamentare faktikisht më datën 2. 8. 2016, por meqë s’kemi mbajtur seancë, kanë pasur fatin të vijnë sot këto pyetje parlamentare, por edhe sot kur po i bëj pyetjen parlamentare ndjehem jashtëzakonisht keq, sepse ende kjo pyetje parlamentare nuk e ka humbur aktualitetin, prandaj, shpresoj që ministri do të na japë një përgjigje.

I nderuar ministër!

Nga viti në vit, në vendin tonë kemi statistika të jetëve të humbura në aksidente komunikacioni, të cilat çdo herë e më shumë po shënojnë rritje. Ligjet në fuqi e rregullojnë transportin rrugor dhe rregullat e komunikacionit.

Ju si ministër i Punëve të Brendshme, a i keni identifikuar se ku qëndron problemi dhe a keni marrë diçka për zvogëlimin e aksidenteve të shumta, të cilat çdo ditë po marrin jetët e qytetarëve të Republikës së Kosovës?

KRYETARI: Urdhëroni, i nderuar ministër, fjala për ju!

MINISTRI SKËNDER HYSENI: E nderuar deputete Musliu!

Të nderuar deputetë!

Keni të drejtë plotësisht. Janë shqetësuese statistikatat për gjendjen në komunikacion përgjithësisht dhe për këtë arsye është duke u draftuar projektligji i ri për komunikacion, ku do të parashihen masa shtesë që plotësojnë atë boshllëk legal, i cili është hetuar gjatë praktikave të deritashme.

Ju siguroj që Policia e Trafikut e Republikës së Kosovës, në bazë të statistikave të lëndëve të paraqitura, është tej mase efikase në ndjekjen dhe përpjekjet për parandalim të tragjeditë në komunikacion. Mirëpo, fatkeqësisht gjykatat janë të stërngarkuara me lëndë të kësaj natyre dhe shpeshherë, jo rrallëherë, dhe kjo është ankesa që te unë vjen shpesh nga eprorët e Policisë, nuk arrin që brenda afateve dhe limiteve legale dhe ligjore të trajtohen lëndët e veçanta për kundërvajtje dhe shkelje në komunikacion.

Sido që të jetë, Policia e Kosovës dhe njësitet përkatëse janë angazhuar edhe në një seri fushatash për vetëdijesim, kryesisht nëpër shkolla, në mënyrë që të respektohet çdo ligjshmëri në komunikacion, mbi të gjitha shenjat e komunikacionit, kufizimet e shpejtësive, përdorimi i rripave të sigurisë dhe segmente e aspekte të tjera të kësaj fushe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sërish deputetja Ganimete Musliu ka pyetje për ministrin Skënder Hyseni.

GANIMETE MUSLIU: Fillimisht do të doja një koment ose pyetje shtesë për këtë pyetje lidhur me pyetjen që tashmë e parashtrova.

Zoti ministër!

Ne si institucione të vendit nuk guxojmë të lejojmë që edhe më tutje, duke u arsyetuar se në gjykatat e Republikës së Kosovës ka lëndë të stërngarkuara, mbi këtë argument të lejojmë që të kemi vdekje të shpeshta në komunikacion dhe të humbim jetët e njerëzve.

A mendoni ju si ministri se ka ardhur momenti që ndoshta, t'i drejtoheni gjykatave po edhe Ministrisë së Drejtësisë me një shkresë, ose me një kërkesë, që të ndërmerret diçka në mënyrë që një herë e përgjithmonë gjykatat të lirohen nga lëndët e stërngarkuara?

Nuk mundemi ne nga viti në vit, nga mandati në mandat, të dalim dhe të arsyetohemi se kemi lëndë të stërngarkuara dhe thjesht për këtë nuk po mund ta kryejmë detyrën tonë.

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Po, sërish keni plotësisht të drejtë, zonja deputete Musliu. Kontaktet me gjykatat janë të përhershme dhe unë e thashë pak më herët, autoritetet e trafikut në Polici të Kosovës bëjnë trysni, kushtimisht po them, institucionale mbi gjykatat në baza të rregullta, që këto lëndë të shihen me prioritet. Mirëpo, sërish po them, pushtetet janë të ndara dhe ne nuk kemi asnjë mundësi që të ushtrojmë ndonjë ndikim më të madh se kaq. Ndërkaq, në Ministrinë e Infrastrukturës me ministrin Zharku e diskutojmë këtë temë në baza periodike të rregullta dhe aktualisht, siç thashë, jemi duke punuar në projektligjin e ri, i cili shpresoj se në një masë të madhe do të adresojë këto shqetësime që ju i shtruat.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja deputete Ganimete Musliu, sërish ka pyetje për ministrin Hyseni.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Më vjen keq, edhe këtë pyetje e kam bërë me datën e njëjtë dhe fatkeqësisht, jo që i është zbehur aktualiteti, por mendoj se është shumë aktuale dhe shumë e patjetërsueshme që të diskutohet.

Pyetja ime për ministrin Skënder Hyseni është:

Duke marrë parasysh se javën e fundit ose dhjetëditëshin e fundit në Kosovë, për dhjetë ditë kemi nëntë vrasje në Republikën e Kosovës, edhe 18 vjet pas lufte në duart e qytetarëve të Republikës së Kosovës korrespondojnë armë pa leje, të cilat rrezikojnë në çdo moment jetën e qytetarëve.

Pamjet televizive, të cilat na u prezantuan nga Policia e Republikës së Kosovës që, quani si të doni, në daç “akte terroriste”, në daç “arsenal”, në daç... çfarëdo tjetër, janë tejet shqetësuese dhe thjesht, te qytetarët ka ndjellë frikë dhe pasiguri.

I nderuar ministër!

A keni ndërmarrë diçka në konfiskimin e armëmbajtjeve pa leje në duart e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe përafërsisht a mund të na tregoni se cilat janë statistikatat për tre vjetët e fundit sa armë janë konfiskuar dhe a ka ndonjë kampanjë urgjente, ndoshta, që do të bëhej për marrjen ose heqjen e këtyre armëve nga duart e qytetarëve. Sepse thjesht, qytetarët ndjehen të pasigurt sot në Republikën e Kosovës pikërisht për shkak se kemi shumë armë në duart e tyre. Dihën pasojat e luftës, që edhe sot janë evidente dhe fatkeqësisht tashmë kanë filluar edhe ato pasojat post-traumatike që pësojmë dhe thjesht kemi një gjendje jo të mirë në Kosovë.

KRYETARI: Po, zoti ministër, fjala për ju!

MINISTRI SKENDER HYSENI: Zonja deputete!

Të dyja pyetjet kanë qenë shumë thelbësore dhe armët e paligjshme janë një problem real, me të cilin edhe Republika e Kosovës përballlet njësoj si të gjitha vendet e rajonit që kanë kaluar nëpër një luftë.

Sipas statistikave nga mekanizmat referues ndërkombëtarë, Republika e Kosovës qëndron në vendin e dytë, sa i përket numrit të armëve të konfiskuara, numrit të armëve ilegale të konfiskuara pas Bosnjë e Hercegovinës, por qëndron më mirë se Shqipëria, më mirë se Serbia gjithsesi, më mirë se Mali i Zi.

Ju kërkuat statistikatat gjatë tre vjetëve të fundit. Policia e Kosovës ka konfiskuar 3900 armë ilegale dhe të gjitha këto armë në pjesën më të madhe janë shkatërruar në vende të specializuara për shkatërrimin e armëve të konfiskuara. Pra, posedimi i armëve në mënyrë të paligjshme është problem real në Republikën e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme, përpos disa marrëveshjeve bashkëpunimi që i kemi nënshkruar dhe disa marrëveshjeve për ngritje të grupeve të ekspertëve, kemi bërë veprime të shumta për konfiskim të këtyre armëve gjithandë ku këto janë hetuar.

Do të vazhdojë të jetë problem grumbullimi i armëve të paligjshme. Në Kosovë kemi 40 mijë armë - 40 mijë armë që kontrollohen me ligj, qoftë ato te Policia a te forcat e tjera të sigurisë.

Ky është numri i përgjithshëm i armëve të legalizuara që janë në përdorim, qoftë nga institucionet, qoftë nga individët, në pajtim me ligjin. Dhe këtu, besoj, pjesërisht iu përgjigja edhe pyetjes së deputetit Rexhep Selimi për sasinë, numrin e madh të armëve që gjenden në mënyrë të paligjshme dhe pa leje adekuate në duart e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Unë këtu, edhe një herë e siguroj deputetin Selimi që Policia ...

KRYETARI: Regjia, mos ua ndal, të lutem, as deputetëve, as ministrit dhe askujt sot fjalën!

MINISTRI SKENDER HYSENI: ... dhe institucionet, përkatësisht Policia e Kosovës nuk do të bëjë asnjëherë ngatërrim të veprave që i has gjatë çfarëdo hetimi dhe ju siguroj se as në raste të caktuara, kjo besoj nuk do të ndodhë. Ndërkohë, i mbetet gjithmonë gjyqësisë të japë fjalën përfundimtare.

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë? Urdhëro, zonja Musliu!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Sinqerisht e çmoj shumë vullnetin dhe gatishmërinë tënde që të na lejoni pafundësisht të flasim, sepse vërtet Kosova ka shumë probleme të cilat i kemi lënë në harresë dhe s'po kemi kohë të merremi me to, sepse i kemi marrë disa kauza të tjera, por megjithatë kërkoj edhe nga ministri që të mos e harxhojë kohën të merret me deputetë të tjerë kur pyetja i shtrohet direkt prej një deputeti, qoftë nga unë, qoftë nga dikush tjetër, me gjithë respektin edhe për ministrin për gatishmërinë për të dhënë përgjigje, por unë konkretisht e kam pyetjen:

-A ka në plan Ministria e Punëve të Brendshme të marrë ndonjë fushatë sensibilizuese ndoshta, sidomos pas këtyre nëntë vrasjeve që kanë ndodhur në Kosovë për konfiskimin, jo grumbullimin, e armëve pa leje, të cilat janë në duart e qytetarëve të Republikës së Kosovës? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër Hyseni, e keni fjalën!

MINISTRI SKENDER HYSENI: Në mbështetje shumë gjeneroze edhe të institucioneve ndërkombëtare, të NDP-së, mbi të gjitha, po edhe të shumë shteteve të Bashkimit Evropian veç e veç dhe të SHBA-së ne jemi aktualisht duke zhvilluar një varg fushatash në fushën e kontrollit të armatimit pa leje, qoftë përmes vetëdijesimit, të fushatave të ndryshme, aksioneve të policisë për konfiskim dhe shkatërrim, sepse armët e konfiskuara në masën më të madhe shkatërrohen ose vihen nën kontroll ligjshëmish. Prandaj, ato fushata nuk mungojnë, janë duke vazhduar dhe do të vazhdojnë edhe tash e tutje.

Natyrisht se vrasjet e fundit të qytetarëve, si gjithmonë, jo vetëm sot, janë shqetësuese dhe duhet të japin alarm për institucionet e sigurisë. Mirëpo, kjo absolutisht nuk do të thotë se Policia e Kosovës në këtë rast konkretisht nuk është duke e bërë punën e vet në baza ditore, sepse është shqetësim parësor i Policisë së Kosovës posedimi i armëve pa leje në masë kaq të madhe.

KRYETARI: Faleminderit! Tani janë dy pyetje radhazi nga deputeti Ismajl Kurteshi për ministrin Arban Abrashi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar, por siç thashë, kjo mbledhje po mbahet në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ti më habite shumë qysh me aq lehtësi të madhe e shkele këtë Rregullore dhe po i shkelni të gjitha ligjet.

Unë pyetjet e mia do t'i lexoj vetëm atëherë kur mbledhjet janë të rregullta dhe për këtë mban përgjegjësi edhe sekretari që e ke aty afër dhe po të këshillon keq, pra shkele Rregulloren se kurrë s'bëhet.

Bëhet fort, edhe për sekretarin, edhe për ty, se në fund të fundit, asnjëri s'jeni mbi ligjin dhe të gjithë do të përgjigjeni për shkeljet që po i bëni. Prandaj, vëni pak gishtin kresë dhe këqyrni çka po bëni.

Pyetjet i lexoj pas 12 shtatorit.

KRYETARI: Faleminderit! Prapë do ta lexoj Rregulloren, pasi ma dha sekretari dhe po më mëson.

Neni 27, pika 3. Kryetari i Kuvendit i njofton deputetët për datën e fillimit dhe të mbarimit të sesionit të punimeve të Kuvendit.

Zoti Haxhiu, ministri Arsim Bajrami nuk është këtu. Urdhëro, zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe pse nuk është ministri, unë po e theksoj një çështje që ka të bëjë me fillimin e vitit shkollor. Është e njëjta çështje që unë tani e katër vjet e ngre në Kuvend, është problemi i çantave të stërngarkuara të fëmijëve dhe që ka shkaktuar probleme serioze në shëndetin e fëmijëve.

Sipas hulumtimeve afër 40% e nxënësve kanë disbalancë muskulore për shkak të peshës së rëndë të çantave dhe qëndrimit apo posturës së keqe, kanë devijime të shtyllës kurrizore, që paraqet problem shqetësues për shëndetin e fëmijëve tanë.

Këtë problem unë tani e katër vjet e ngre këtu në Kuvend, edhe pse në fillimin e vitit të kaluar shkollor, kur ia kam parashtruar këtë pyetje ministrit të Arsimit, zoti Arsim Bajrami ka premtuar do të zgjidhet dhe ajo çka kemi parë deri në përgatitje të tashme të fillimit të këtij viti shkollor duket se nuk ka ndonjë interesim që ky problem të zgjidhet, është pothuaj se pesha e njëjtë e çantave për të gjitha klasat, prandaj kërkoj edhe një herë nga Ministria e Arsimit që vërtet ta trajtojë këtë problem, dhe jo vetëm Ministria e Arsimit, por edhe drejtoritë e arsimit nëpër komuna, të cilat kanë për obligim ta zgjidhin këtë problem, për arsye se ky është një problem shumë serioz i fëmijëve tanë.

Prandaj, e parashtrova pyetjen edhe pse s'është ministri këtu, për arsye se jemi në prag të fillimit shkollor dhe është një çështje që duhet të rregullohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! E kemi edhe një pyetje.

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për ministrin, që ka qenë në atë kohë ministër i Drejtësisë zoti Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër, e tani ministre është Dhurata Hoxha. A pranoi ta bëni pyetjen, dhe atë ministres? Urdhëroni, zonja deputete!

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Çështja që e kam ngritur ka qenë më 7. 7. 2016 dhe është e vërtetë se atëherë ka qenë ministër zoti Hajredin Kuçi.

E nderuar zonja ministre, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, për të funksionuar në përputhje me ligjin 04-L/017 për ndihmë juridike falas, neni 4 dhe neni 22 duhet të ofrojë ndihmë juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet zyrave rajonale. Ndërsa, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ndihma juridike falas është kategori kushtetuese e paraparë me nenin 31, paragrafi 6.

Zonja ministre, deri më tani janë të hapura zyrat rajonale për ndihmë juridike falas në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjilan e Prizren. Dhe, duke e ditur se nga viti 2009 zyrat e tilla në Ferizaj dhe Gjakovë kanë funksionuar të mbështetura nga projekti i financuar nga UNDP-ja dhe nga Ambasada Norvegjeze. Pas përfundimit të projektit këto zyra janë jashtë funksionit.

Pyetja është kështu:

- Duke qenë e njoftuar se nevojat e qytetarëve për shërbime të kësaj zyre janë të mëdha, çfarë keni ndërmarrë që edhe qytetarët e rajoneve të Ferizajt dhe Gjakovës të kenë trajtim të barabartë ligjor me banorët e rajoneve ku ky shërbim u jepet apo afrohet falas? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Ministrja e Drejtësisë, zonja Dhurata Hoxhaj, e ka fjalën.

MINISTRJA DHURATA HOXHAI: Të nderuar deputetë,
E nderuar deputete Mjaku-Topalli,
Fillimisht ju falënderoj për pyetjen tuaj sa i përket çështjes së ndihmës juridike falas, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë, e cila do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

Sa i përket pyetjes tuaj, ju njoftoj se në pajtim me përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin përkatës, Ministria e Drejtësisë në vitin 2012 ka hartuar Ligjin për ndihmë juridike falas, me ç'rast është themeluar edhe Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

Sipas nenit 19 të Ligjit, Agjencia është institucion i pavarur publik, i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me ligjin dhe po ashtu Agjencia është institucion i vetëm në territorin e Republikës së Kosovës përgjegjës për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas. Kurse sa i përket çështjes së zyrave rajonale të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, gjithashtu kjo është kompetencë e Këshillit të Agjencisë, i cili përcaktohet me vendim të veçantë.

Megjithatë, ne jemi të njoftuar për nevojën për t'u funksionalizuar zyrat në Ferizaj, dhe për problemin e njëjtë, që e kemi edhe në Gjakovë, Ministria e Drejtësisë e ka përfaqësuesin e vet në Këshillin Drejtues dhe brenda mundësive do të mundohemi ta adresojmë këtë çështje dhe të gjejmë zgjidhje me ndihmën e donatorëve sa më shpejt që është e mundur. Pra, jemi duke u marrë me këtë çështje.

Për më tepër, Ministria e Drejtësisë është thellësisht e përkushtuar që legjislacionin ekzistues ta plotësojë apo ta ndryshojë me qëllim të vetëm të ofrimit të shërbimeve sa më efikase për qytetarët tanë, nëse ka nevojë për një gjë të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja deputete, keni pyetje shtesë? Faleminderit! Atëherë, është një traditë për deputetët e rinj ta bëjnë betimin, kurse ministrat vetëm në fillim.

Ministria e ka filluar tani punën dhe ia urojmë detyrën, por s'kemi procedura gjatë prezantimit, është dashur drejtpërdrejt të futemi në pika të rendit të ditës.

Pra, urime detyra, zonja ministre e Drejtësisë!

Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancës plenare të mbajtur me 4 dhe 5 gusht 2016?

Meqenëse s'ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 4 dhe 5 gusht 2016.

Të nderuar deputetë!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, me shkresë, të nënshkruar nga deputeti Glauk Konjufca, kryetar i Grupit Parlamentar, datë 30 gusht 2016, ka njoftuar se i ka tërhequr dy interpelancat e parashtruara, të cilat janë të radhitura në seancën e sotme plenare në pikat 4 dhe 5 të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Ndërkohë, si kryetar i Kuvendit, kam marrë një njoftim nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe lidhur me këtë ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës ta paraqesë qëndrimin.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Të nderuar deputetë!

Të nderuar qytetarë!

Unë, si kryeministër, konsideroj se sot nuk janë rrethanat dhe nuk është situata në të cilën duhet ta trajtojmë dhe të votojmë Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes me Malin e Zi, prandaj Qeveria e tërheq sot këtë ligj nga rendi i ditës dhe nga procedura kuvendore.

Do të mundohemi që në ndërkohë të arrijmë një bashkëbisedim dhe qëndrim të përbashkët lidhur me ligjin, sepse konsideroj që nuk është në rregull që për këtë ligj të diskutojmë dhe të trajtojmë në situatën kur kemi edhe presione nga deputetë dhe kërcënime, në situatë kur një grup parlamentar e kushtëzon votimin e këtij ligji në koncesione dhe nuk dëshirojmë të bëjmë asnjë koncesion për një ligj, i cili përcakton sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës.

Tërheqja e këtij ligji nuk nënkupton që ne do ta rishqyrtojmë ose ta negociojmë marrëveshjen, por do të diskutojmë për ligjin dhe do ta procedojmë në Kuvend në momentin kur Qeveria vlerëson se është koha. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, bëhet tërheqja e pikës së gjashtë të rendit të ditës me kërkesën e Qeverisë.

Jemi në pikën e shtatë të rendit të ditës.

Nëse e ke për pikën e shtatë, urdhëro! Pra, zoti Daut Haradinaj, e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Kjo, domethënë, se po flasim për numra, nëse e kuptova saktë kryeministrin.

Së pari, ti, kryetar, duhesh të na tregosh sa deputetë jemi në sallë. Është rregull, domethënë, ti duhesh të deklarojsh: në sallë janë kaq deputetë.

Për ratifikimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare nuk kërkohet votim i dyfishtë i komuniteteve dhe nuk ka nevojë hiq për Listën serbe të kushtëzohemi, se ja ku jemi këtu, jemi më shumë se sa 100 deputetë në sallë.

Kështu që kjo nuk qëndron, sepse nuk kanë nevojë as të votojnë për, as kundër, ne jemi deputetë këtu dhe e japim votën.

Është krejt diçka tjetër, domethënë, që e kemi konstatuar atë marrëveshje që nuk është e drejtë dhe nuk është e saktë.

Prandaj, edhe një herë e kemi edhe ish-ministrin e Drejtësisë këtu që e njeh mirë Kushtetutën, kemi edhe profesorë të tjerë që kanë punuar në Kushtetutë bashkë, e kemi edhe Haki Demollin, le të na thonë se për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nuk ka nevojë asnjë deputet i pakicës e as i shumicës, të gjithë jemi deputetë të barabartë.

KRYETARI: Ju kisha lutur, në rend të parë, është rast i mirë si deputetë të jenë të gjithë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, edhe opozita. Kjo është edhe arsyeja pse desha t'ua jepja fjalën.

Në të njëjtën kohë, nga çdo grup do t'ua japim fjalën, zoti Fatmir Limaj, nga "Nisma" e ka fjalën.

Zafir, e ka marrë fjalën! Glauk, a e ke kërkuar fjalën, se po e shoh, atëherë po ke problem ose t'i po e prek aty, tash është mirë, por po e shoh çdo herë emri yt po del.

FATMIR LIMAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
Unë e dëgjova propozimin e kryeministrit.
Natyrisht, sipas Rregullores, propozuesi i ligjit do të thotë mund ta tërheqë projektligjin.

Por këtu kemi të bëjmë me një çështje krejt të veçantë dhe ishte shumë e paqartë arsyeja e tërheqjes së ligjit, është krejtësisht e paarsyetuar.

Pse po tërhiqet sot ky ligj, që më tepër se një vit është kërkuar të votohet nga Qeveria?

Arsyetimi se po tërhiqet ligji, sepse një grup parlamentar nuk është këtu prezent dhe po na kushtëzon, është një arsyetim i paqëndrueshëm, sepse Parlamenti i Kosovës nuk mund të kushtëzohet nga një grup parlamentar.

Ligji, të cilin e kemi në procedim për ta votuar nuk e kërkon votën e dyfishtë të minoritetit. Ka kuorum ky Parlament të procedojë. Numri i deputetëve është i mjaftueshëm për të shkuar në procedim.

Në qoftë se Qeveria e Kosovës del sot e na thotë se po e tërheqim këtë projektligj se ka nevojë të rishikohet, atëherë është çështje tjetër.

Në qoftë se Qeveria këtu del, e duhet ta marrë guximin qeveritar, guxim shtetëror, nacional e të dalë e të thotë: “Po, këtë projektligj po e tërheqim, sepse duhet të rishikohet edhe një herë nga fillimi dhe të gjitha ato dyshime e dilema që janë ngritur për një vit të rishikohen edhe një herë, të shihen gabimet, të përmirësohet aty ku ka nevojë të përmirësohet, ose të vërtetohet varianti aktual, ama me një rishikim të tërësishëm, ashtu siç ka kërkuar opozita”.

Dhe, në qoftë se vjen ky propozim, atëherë ky është propozim që e ndihmon vendin. Ky propozim është në përgjegjësinë e duhur shtetërore dhe aty besoj pastaj do ta ndërtonim një konsensus të përbashkët dhe të gjithë do të pajtohemi me tërheqjen e këtij projektligji, për të shkuar dhe krijuar një komision ashtu siç kemi thënë dhe për ta rishikuar në tërësi këtë proces dhe në fund të vijmë të gjithë së bashku për ta miratuar këtë projektligj.

Ama, se u tërhoq sot ligji sepse Lista serbe nuk është këtu dhe për atë jo, fakti është diku tjetër. Nuk i keni votat. Nuk i keni votat për ta votuar demarkacionin në variantin të cilin e keni, nuk i keni, jo për shkak të Listës serbe. S'i keni brenda deputetët e Parlamentit të Kosovës dhe nuk është asgjë tragjike, duhet të thoni: “Nuk i kemi votat, sepse ky variant nuk ka arritur t'i bindë deputetët e Parlamentit të Kosovës”.

Ne kemi nevojë dhe ende kohë për t'u bindur të gjithë, për t'i hequr këto dilema dhe nuk ka nevojë të rrahët gjoks. Hajde, të ulemi, ta kthejmë këtë projektligj, ta rishikojmë në tërësi. Okej, e keni miratimin tonë. Jo, nuk e kthejmë, por do ta bëjmë derisa t'ia mbushim mendjen secilit deputet veç e veç, atëherë kjo është e dëmshme, veç po e thellojmë krizën.

Prandaj, i nderuar kryeministër, nuk e di a është këtu, kisha kërkuar nga ju të jeni më i qartë me arsyetimin e tërheqjes së këtij ligji, për të cilin dje, pardje, rrafsh për sa muaj, sidomos javën e fundit, keni thënë: “I kemi votat, jemi unanimesë, kemi me votu, s’ka gjë që na ndal”. Hajde, nxirreni dhe ta votojmë. Hajde, ta votojmë. Problemi është se kanë dalë disa gjëra të tjera, Lista serbe po thotë se i keni dhënë disa premtime që duhet t’i bëni publike, s’i keni përmbushur premtimet dhe, jo për siguri, hiq s’është punë sigurie këtu. Por thjesht, Lista serbe po thotë s’i keni përmbushur disa premtime, kur të na i përmbushni premtimet, tani ndalemi dhe këqyrim a vijnë në Parlament apo jo. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, kemi deklarinimet e grupit parlamentar, por kjo është tema në të cilën nuk kemi çka të diskutojmë. Ndërkohë, po shkojmë nga opozita, Glauk, e ke fjalën, e ka Ismeti edhe Zenuni në fund.

Ok, Zenuni, Ismeti si të doni, mendova prej partive më të vogla.

GLAUK KONJUFGA: Deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës! Unë mendoj që ky demarkacion apo më mirë të themi këtë demarkacion kaq të gabuar, ashtu siç na e solli këtu Komisioni shtetëror, i ngarkuar me detyrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, asgjë nuk e përshkruan atë më mirë se sa ikja e turpshme këtu pak më parë e kryeministrit, duke e konfirmuar faktikisht dështimin e këtij demarkacioni në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Unë, zonja dhe zotërinj, këtë nuk e konsideroj tërheqje të Qeverisë, ky ishte një votim. Unë sot do ta konsideroj këtë votim çka ndodhi, dhe pse dështoi sot demarkacioni në Kuvendin e Republikës së Kosovës unë mendoj që e kanë ndihmuar pesë faktorë, të cilët dëshiroj t’i falënderoj. Kam rastin t’i falënderoj këta pesë faktorë shumë të rëndësishëm që e sollën situatën deri këtu: e para, populli dhe shoqëria e pakënaqur me këtë demarkacion. Janë shprehur edhe nëpër sondazhe, mbi 70% në çfarëdo sondazhi që është bërë me qytetarët, me popullin e Kosovës, e ka shprehur pakënaqësinë. Këto sondazhe janë shumë kredibile, mbi 75% e popullit të Kosovës ka qenë i pakënaqur me demarkacionin, ky është faktori i parë.

E falënderojmë këtë popull të vetëdijshëm, këta qytetarë aktivë që nuk kanë përtuar të dalin edhe nëpër protesta, edhe nëpër demonstrata, nëpër sheshet e Kosovës.

Ata të dytit që dua t’i falënderoj janë ekspertët e pavarur, profesorët me profesionalizmin e tyre dhe me integritetin e tyre shkencor që kanë ofruar argumente të bollshme, që nuk janë dorëzuar para asnjë trysnie dhe të gjitha i kanë nxjerrë në tavolinë dhe na kanë bindur edhe neve. Ne si deputetë të Kosovës e kemi mësuar më mirë prej profesorëve tanë të nderuar të Universitetit të Prishtinës, prej ekspertëve që kanë ofruar argumente dhe fakte, e dëshiroj t’i falënderoj edhe ata, ky është faktori i dytë.

Faktori i tretë janë ata që nuk e kanë kursyer kundërshtimin e tyre edhe po vuajnë në burgje. Janë aktivistët e shumtë të shoqërisë sonë, të cilët aktualisht ndodhen në burg dhe meqenëse po konfirmohet që demarkacioni është një kauzë e gabueshme e Qeverisë së Kosovës, duhet t’i lironi menjëherë këta aktivistë nga burgju.

Faktorin e katërt që dua ta falënderoj shumë, janë deputetët e LDK-së dhe të PDK-së. Me qëllim po i vendos ata para se ta falënderoj opozitën, se ata e kanë pasur më vështirë se ne, për arsye se të jesh deputet në LDK dhe ta kundërshtosh dhe të mos i bindesh trysnisë, nuk është njësoj si të jesh në opozitë dhe t'i shprehësh mendimet e tua lirshëm, edhe në PDK, për shembull.

Pra, i falënderoj Vjosa Osmanin me shokë e me shoqe dhe Nait Hasanin me shokë në PDK, që e bënë të pamundurën që Qeveria të mos i ketë numrat. Isa Mustafa mund të thotë që... në fund t'ia lërë krejt meritat Listës serbe. Edhe në fund, pa dyshim e falënderoj opozitën, sepse falë një konsistence në kundërshtim me rezistencë, prej shtatorit të vitit të kaluar, duke mos kursyer as burgun, as trysninë e Qeverisë, kenë ofruar të gjitha ato... e falënderova, Armend, popullin...Më së pari ishte populli. Mos u bëj nervoz tash. Popullin e falënderova, duke nisur prej Rugove e deri në Llap, mos m'i diskrimino këta të tjerët, janë të gjithë aty të bashkuar në protestë.

Kështu që krejt këta faktorë bënë që demarkacioni të mos votohet sot, mirëpo unë këtë faktikisht e konsideroj njëfarë votimi dhe kështu do të sillen veprimet e mia politike, sikur është votuar dhe ka dështuar. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, fjalën e ka zoti Pajaziti. Të bëhet gati zoti Beqiri dhe këta pa grup po duan të flasë njëri prej tyre, Shaip Muja. Kështu e përfundojmë këtë pjesë, të mos shkelim rregulloren.

ZANUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Unë kam kërkesë prej kolegëve deputetë që të respektojmë Rregulloren. Është mirë që të respektohet Rregullorja e punës së Kuvendit, në mënyrë që të mos abuzohet me foltoren, aq më tepër, në një ditë kur kemi ditë pune dhe aq më tepër është edhe një presion jashtë me njerëz që janë ftuar të protestojnë.

Sot patëm një kërkesë të kryeministrit për ta hequr prej rendit të ditës një pikë. Është mirë ne të votojmë për ose kundër. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, pavarësisht numërimit të argumenteve për çka tërhiqet ky votim, për vetë faktin e votimit, siç e shpjegoi kryeministri, për një atmosferë tjetër, një kohë më të qetë, pa presione, ne pajtohemi dhe e mbështesim.

Shfrytëzoj rastin që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike po ashtu t'i ftoj të gjitha grupet politike dhe etnike që të krijojnë atmosferë dhe kushte, të kontribuojmë bashkërisht, që të krijojmë kushte më të qeta, pa presione dhe pa kushtëzime të vazhdojmë trajtimin e kësaj çështjeje dhe çështjeve të tjera që janë në interes të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Pajaziti, faleminderit! Më lejoni, të nderuar kolegë deputetë, një lëshim imi i vogël, Zenun Pajaziti është kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe qëndrimi ishte në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Zoti Beqiri, e ka fjalën dhe në ndërkohë pa grup, nuk po mund të merren vesh. Vazhdojmë me pikën e shtatë menjëherë.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

E drejta e kryeministrit, por edhe e çdo ministri, për tërheqje të projektligjeve të caktuara është një e drejtë e rregulluar me Rregulloren dhe mënyra e tërheqjes, përmbajtja... dikujt mund të mos i

pëlqejë, por kryeministri i tha shumë qartë arsyet përse duhet të tërhiqet projektligji nga procedurat kuvendare. Ajo që për ne është me rëndësi, të gjitha këto tentimet më vonë që të abuzohet me fjalën gjatë paraqitjeve në emër të grupeve, është vetëm vazhdim i një demagogjie, thirrje në popull, në 75%,... nuk jam ai që dal i numëroj sa kanë qenë sot, a ka qenë... gjithë ai popull. Është e drejtë dhe 7 vetë të protestojnë, po edhe 700 mijë, por të thirrësh aq shumë në popull, se edhe ne të gjithë jemi deputetë që na ka votuar dikush, por ky është fjalor që vazhdojnë ta përdorin, dhe le ta përdorin, por ajo që është me rëndësi është se kryeministri i vendit e realizoi një të drejtë të tij që ta tërheqë këtë projektligj. Kurse ata që shumë po thirren në emër të deputetëve të LDK-së, dhe unë mund t'u them se e keni shumë gabim në paraqitjet tuaja për marrjen e rolit se kush e çfarë do të bëjë me rastin e votimit nga deputetët e LDK-së. Pra, mos u ngutni, këqyrni punët tuaja, këqyrni deputetët tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Ndërkohë do të vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës dhe mund ta merrni fjalën vetëm nga një minutë, me marrëveshje. Mos abuzoni më shumë me mua, e as me Kuvendin. Atëherë, për një minutë e ka fjalën Gëzim Kelmendi, e po ashtu edhe Shaip Muja. Urdhëro, Shaip Muja, meqenëse Gëzimi po ju jep përparësi. Gëzim, përgatitu pastaj për fjalë.

Ju kisha lutur për dinjitet, të nderuar deputetë! Për nga dy minuta kanë mundësi të shprehen deputetët.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Glauku po thotë, më fal se të kam harruar, por nuk është e vërtetë çka thotë Glauku, sepse s'kanë ofruar asnjëherë zgjidhje.

Unë personalisht i kam thirrur në komision dhe asnjëherë nuk janë lajmëruar, por e kanë zgjedhur çështjen e rrugës, prandaj unë sot po them diçka për çka nuk do të ketë nevojë të keqpërdoret foltorja këtu, prandaj Qeveria mendoj se sot e ka bërë një gabim që nuk e ka dhënë një rrugëzgjidhje, e cila do të kishte mundur të ishte ligjore.

Unë propozoj që, duke u bazuar në informatën e 3 gushtit, se me Malin e Zi ekzistojnë 3 lloj të kufijve, propozoj që vija kufitare në mes të Kosovës dhe Malit të Zi të demarkohet nëpër segmentet sipas vijës së dytë dhe sipas mbulueshmërisë së hartave zyrtare të dy shteteve.

Mali i Zi, sipas hartave zyrtare të dorëzuara nga Qeveria e këtij shteti në Adriatik Atllas....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Më fal, Shaip, tash e ka fjalën Gëzim Kelmendi! Atëherë, ia jepni mundësinë të vazhdojë deputetit Muja se po do të na e japë një propozim.

Edhe diçka, të nderuar deputetë, seanca menjëherë pas përfundimit të këtyre dy diskutimeve, seanca pranverore mbaron sot dhe në bazë të Kushtetutës do të fillojmë me seancën vjeshtore.

Urdhëro, le të vazhdojë Shaipi të paraqesë atë propozim, e pastaj Gëzimi e merr fjalën.

SHAIP MUJA: Të nderuar kolegë!

Ekziston një hartë, për të cilën mundësitë mund të realizohen edhe me norma ndërkombëtare, pa incidente ndërkombëtare, të cila po zhvillohen.

Prandaj, nëse Mali e Zi e respekton “Adriatik Atlas Word of Meps”, s’po i kërkojmë asgjë tjetër nën numrin 2010/14 dhe Kosova sipas hartës së zonave kadastrale të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të vitit 1974, të punuar nga Drejtoria për Gjeodezi e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, kufiri duhet të kthehet në normën e vitit 1974.

Këto janë vizatime faktike, të gjetura dhe të cilat unë mendoj që komisionet në Kuvend dhe kryetari i Kuvendit duhet të formojë komisione të specializuara edhe me ekspertë dhe kryesisht ekspertë të cilët vijnë nga pozita, ndërsa opozita, përveç në komisionin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti Kelmendi e ka fjalën! Të nderuar deputetë, ende s’ka përfunduar seanca.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

Unë, pa dashur të zgjas më shumë, do të mundohem që brenda minutës së kufizuar të flas.

Unë mendoj se sot është arritur një fitore e madhe e dyfishtë. Fitorja e parë është se ka dështuar të votohet marrëveshja për ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi, ndërsa fitorja tjetër është për faktin se ky dështim i ka vënë para një argumenti të qartë të gjithë ata deputetë të cilët kishin për ta votuar këtë marrëveshje dhe se, nëse e votojnë këtë marrëveshje, do ta bënin ndarjen e dytë – do t’i plotësonin kushtet e Listës serbe, e cila ka kushtëzuar.

Prandaj, me këtë dështim, e kemi një fitore të dyfishtë, nga se të gjithë ata deputetë e kanë tashmë të qartë se nëse e votojnë këtë marrëveshje, përveç dëmit që do t’ia shkaktojnë Kosovës, duhet t’i plotësojnë edhe kushtet e Listës serbe, të cilat i ka kërkuar.

Dhe, për fund, pa dashur të zgjas më shumë, kryeministri i Republikës së Kosovës e tha një fjalë të madhe: “Nuk do ta realizojmë këtë votim të projektligjit të kësaj marrëveshjeje për faktin se nuk e pranojmë koncesionin nga Grupi i Listës serbe”.

Prandaj, kryeministri shpresoj se do t’i qëndrojë besnik kësaj fjale se nuk do të pranojmë koncesione.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë!

Jemi në përfundim të seancës dhe përfundon sesi prandaj, dhe në bazë të Kushtetutës do të fillojmë sesionin vjeshtor të hënën e dytë të shtatorit.

Faleminderit dhe mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*